

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE TREGTARE
“ ALPHA POP ” SH.P.K

Ne baze te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” dhe Ligjit Nr.9273 date 03.07.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”,me date 24.02.2020 ,ne Ortaket e Shoqerise Tregtare “ALPHA POP ”SH.P.K,shtetasit: Agustin Xhovan Gega, 18.08.1994,lindur ne Greqi dhe banues ne Greqi,shtetas shqiptar I identifikuar me ID,Nr.J40818068D, dhe shtetasja Rina Avni Balaj e datelindjes 27.10.1999, lindur ne Peje dhe banuese ne Peje, shtetase Kosovare e identifikuar me ID Nr 1242763064, ne perputhje edhe me statutin e shoqerise hartojme kete AKT-THEMELIMI.

LLOJI DHE EMRI SHOQERISE

NENI 1

Lloji I Shoqerise Tregtare eshte Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar dhe emir I saj eshte “ALPHA POP ”SH.P.K.

SELIA E SHOQERISE

NENI 2

Zyra Qendrore e Shoqerise Tregtare “ALPHA POP”SH,P,K.,e ka vendodhjen ne Lagjja 8 Durres , Rruga Oslo, Godina nr. 5

REGJIMI JURIDIK

NENI 3

Shoqeria eshte shqiptare e me pergjegjesi te kufizuar.

Shoqeria fiton personalitetin juridik qe ne momentin qe ajo regjistrohet prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 4

Objekt I Shoqerise Tregtare "ALPHA POP" SH.P.K eshte :

Aktivitet ne fushen e muzikes, Studio muzikore, kengetar.

KOHEZGJATJA

NENI 5

Shoqeria Tregtare "ALPHA POP" SH.P.K.,do te kryej veprimtarine dhe aktivitetin e saj per nje

periudhe kohore te papercaktuar.

Ajo mund te shperbehet ne cdo kohe dhe per cfaredo lloj shkak.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6

Kapitali Themeltar I regjistruar I Shoqerise Tregtare "Alpha Pop" SH.P.K.,perbehet prej 100.000 (njeqindemije) leke.

Pjesmarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme :

Ortaket themelues : Z.Agustin Gega : Zoterues I 1 (nje) kuoteme vlere te pergjithshme qe perben 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise dhe Znj.Rina Balaj : Zoterues I 1 (nje) kuoteme vlere te pergjithshme qe perben 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

ADMINISTRIMI

NENI 7

Administrator I Shoqerise I emeruar nga Asambleja e Ortakeve eshte Z.Agustin Gega me nje afat 5 vjet me te drejte rizgjedhje.

TE DREJTAT E SHOQERISE

NENI 8

Shoqeria ka te drejte te lidh kontrata dhe te nenshkruaj marreveshje Brenda dhe jashte vendit.

Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e derdhur.

Shoqeria perballon humbjet vetem dhe deri ne kufirin e vleres se kontributit te Kapitalit Themeltar.

VITI FINANCIAR-EKSPERTET

NENI 9

Viti financiar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe perfundon me 31 Dhjetor.

SHPERNDARJA E FITIMIT

NENI 10

Fitimi qe do te shperndahet perbehet nga fitimi i vitit financiar te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per rezerven sipas ligjit dhe nga ana tjeter jane zbritur ose jane shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e meparshme.

Ky fitim shperndahet midis Ortakeve te Shoqerise sipas kontributit te kuotave ne kapitalin themeltar te shoqerise.

LIKUJDIMI

NENI 11

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilen parashikojne menyren e likujdimit te shoqerise, duke caktuar l apo disa likujdatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likujdatorit dhe emeratesen shtese "shoqeri ne likujdim e siper".

Likujdimi kryhet nga likujduesit e emeruar nga Ortaket.

Aktin e themelimit e lexuam dhe e gjetem konform vullnetit tone dhe e nenshkruajme pa verejtje.

26/01/2020

**ORTAKET E SHOQERISE
ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ALPHA POP " SHPK**

AGUSTIN GEGA

RINA BALAJ



STATUTI I SHOQERISE TREGTARE

“ALPHA POP” SH.P.K

Ne baze te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” dhe Ligjit Nr.9273 date 03.07.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”,me date 24.02.2020 u krijua Shoqeria Tregtare “ALPHA POP” SH.P.K,me Ortake shtetasin Agustin Xhovan Gega I datelindjes 18.08.1994,lindur ne Greqi dhe banues ne Greqi ,shtetas Shqiptar I identifikuar me ID,Nr J40818068D, dhe shtetasja Rina Avni Balaj e datelindjes 27.10.1999, lindur ne Peje dhe banuese ne Peje, shtetase Kosovare e identifikuar me ID Nr 1242763064, e cila do te funksionoje ne baze te ketij STATUTI.

LLOJI DHE EMRI SHOQERISE

NENI 1

Lloji I Shoqerise Tregtare eshte Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar dhe emri I saj eshte “ALPHA POP ”SH.P.K.

ZYRA QENDRORE DHE TERRITORI

NENI 2

Zyra Qendrore e Shoqerise Tregtare “ALPHA POP ”SH,P,K.,e ka vendodhjen ne Lagjja 8 Durres ,Rruga Oslo, Godina nr. 5

NENI 3

Veprimtarine e saj Shoqeria Tregtare “ALPHA POP”SH.P.K,ka te drejte ta ushtroje ne te gjithë territorin e Republikes se Shqiperise si dhe jashte saj.

Shoqeria e fiton personalitetin e saj juridik qe nga moment I regjistrimit ne organet perkatese.

OBJEKTIVAT DHE KOHEZGJATJA

NENI 4

Objekt I Shoqerise Tregtare “ALPHA POP”SH.P.K eshte :

Aktivitet ne fushen e muzikes, Studio muzikore, kengetar.

NENI 5

Shoqeria Tregtare "ALPHA POP" SH.P.K., do te kryej veprimtarine dhe aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6

Kapitali Themeltar I regjistruar I Shoqerise Tregtare "ALPHA POP" SH.P.K., perbehet prej 100.000 (njeqindemije) leke.

Pjesmarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme :

Ortaket themelues:

Z.Agustin Gega :Zotcrucs i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise, dhe Znj.Rina Balaj :Zoteruese e 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.

ZMADHIMI DHE ZVOGLIMI I KAPITALIT

NENI 7

Kapitali shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje ekspertiti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkese administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyre nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit mund te lejohet nga Asambleja e Ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohet per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

TRANSFERIMI KAPITALIT

NENI 8

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet :

- a- Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b- Shitblerjes
- c- Trashegimise
- d- Dhurimit
- e- Cdo menyre tjeter te parashikuar ne ligj

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve,persa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

NENI 9

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhteme :

- a- Ndryshimin e statutit
- b- Emerimin e shkarkimin e administratoreve
- c- Emerimin e shkarkimin i likujduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
- d- Percaktimin e shperblimeve per administratoreve,likujdatoreve dhe eksperteve te autorizuar.

dh-Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret,perfshire pegatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.

- e- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- f- Zmadhimin e zvogelimin e kapitalit.
- g- Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- h- Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- i- Riorganizimin e prishjen e shoqerise.
- j- Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese.
- k- Ceshtjeve te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme,ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjer apo nga nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme,e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

MENYRA E THIRRJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

NENI 10

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose,nese parashikohet nga statuti,me njoftim nepermjet postes elektronike.Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje,vendin,daten,oren e mbledhjes dhe rendin e dites e tu dergohet te gjithe ortakeve,jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mledhjen e asamblese.

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni,ako mund te marre vendime te vlefshme nese te gjithe ortaket jane dakord,per te marre vendime,pavaresisht parregullise.

KUORUMI

NENI 11

Ne rastin e marrjes se vendimeve,qe kerkojne nje shumice te zakonshme,asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote,qe zoterojne me shume se 3 perqind te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje,te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare",ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem,nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave,jane te pranishem personalisht,votojne me shkrese,apo mjete elektronike,sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuoromit te permendur me lart,asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite,me te njejtin rend dite.

MARRJA E VENDIMEVE

NENI 12

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit,te ortakeve pjesmarres,per ndryshimin e statutit,per zmadhimin ose

zvogelimin e kapitalit te regjistruar,shperndarjen e fitimeve,riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres,per ceshtje te tjera si :

a-percaktimi i politikave tregtare te shoqerise

b-emerimin dhe shkarkimin e administratoreve

c-emerimin dhe shkarkimin i likujdvesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar

d-percaktimin e shperblimeve

dh-mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret,perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise

e-perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve

f-miratimin e rregullave proceduriale te mbjedhjeve te asamblese

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet ne QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

NENI 13

1.Ortaket nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per :

a-vlersimin e veprimtarise se tij

b-shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij

c-ngritjen e ndonje padie ndaj tij nga shoqeria

d-dhenien ose jo te perfitimeve te reja

2.Kur ndonjeri nga ortaket perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar,i autorizuari vlersohet te jete ne te njejtin konflikt interesi,ashtu si dhe ortaku,te cilin perfaqeson.

ADMINISTRIMI

NENI 14

Asambleja e pergjithshme emerone nje ose me shume persona fizik si administrator te shoqerise. Afati i emerimit eshte 5 vjet, me te drejte riprteritje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne QKB.

Administratoret e nje shoqerie tregtare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqerie te kontrolluar e anasjelltas. Cdo emerim i bere ne kundershtrim me keto dispozita eshte i pavlefshem.

Administrator i Shoqerise Tregtare "ALPHA POP" SH.P.K., emerohet Z. Agustin Gega me nje afat kohor 5 vjet, me te drejte riprteritje.

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

NENI 15

Administratori ka te drejte dhe detyrohet te :

a) kryej te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikaten tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme.

b) perfaqesoje shoqerine tregtare

c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise

d) pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor te shoqerise, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumenta perpara asamblese se pergjithshme per miratim

dh) krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarvajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise.

e) kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Biznesit.

f) kryejne detyra te tjera te parashikuara ne ligj dhe statut.

Administratoret jane te detyruar te therrasin asamblene e prgjithshme, ne rastet kur:

- Sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezultone ose ekzistone rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

- Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive,te cilat kane nje vlere me te larte se 5 per qind te aseteteve te shoqerise,qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- Shoqeria brenda 2 viteve te para te regjistrimit te saj,propozon te bleje nga nje ortak pasuri,qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteteve te shoqerise,qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Nese asambleja emerom me shume se nje administrator ata e administrojne bashkarisht shoqerine.

Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme.Padite,qe lidhen me shperblimin e administratorit,ne baze te marrdhenieve kontraktore me shoqerine,rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

NENI 16

Administratori eshte pergjegjes individualisht,ndaj shoqerise ose ndaj te treteve,per shkelje te ligjeve,shkelje te statutit,apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marrveshjeve te kryera pa miratim nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise,i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marrveshjen,per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise,sipas neneve 14.15 ,17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare",administratori detyrohet :

1.a)te kryej detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim dhe ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi,duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis.

b)te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita.

c)te vleresoje me pergjegjesi ceshtjet,per te cilat merret vendim.

d)te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit,prezent ose te mundshem,te interesave personale me ata te shoqerise.

dh)te ushtroje detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem.

2.Administratori,gjate kryerjes se detyrave te tij,pergjigjet para shoqerise per cdo veprim ose mosveprim,qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare,me perjashtim te rasteve kur,ne baze te hetimit dhe vlersimit te informacioneve perkatese,veprimi ose mos veprimi eshte kryer ne mirebesim.

3. Nese administratori vepron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e dy te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standarteve te kerkuara.

4. Ne menyre te vecante, por pa kufizuar ne to, administratore eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundershtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e meposhtme :

1. u kthen ortakeve kontributet
2. u paguan ortakeve interesa apo dividend
3. u shperndan aktivet shoqerise
4. lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet
5. jep kredi

Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit.

Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblim financiar, nese eshte e nevojshme. Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

VITI FINANCIAR-EKSPERTET

NENI 17

Viti financiar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe perfundon me 31 Dhjetor.

EKSPERTET

NENI 18

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise,ate gjithëvjetore dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara,te cilat eshte i detyruar t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe kane.

PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQERISE

NENI 19

Prishja dhe likujdimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a)kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj
- b)me vendim te Asamblese se Ortakeve
- c)me hapjen e procedurave te falimentimit
- d)nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit Nr.9723,date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit".
- e)me vendim te gjykates

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilen parashikojne menyren e likujdimit te shoqerise,duke caktuar 1 apo disa likujdatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likujdatorit dhe emertesën shtesc "shoqeri ne likujdim e siper".

Likujdimi kryhet nga likujduesit e emeruar nga Ortaket.

Nese Ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likujduesve,brenda 30 dite pas prishjes,cdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates,per te caktuar nje likujdues.

NENI 19

Riorganizimi i shoqerise bashkimi-ndarja.

Shoqeria mund te ndahet,bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve,ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2012 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

NENI 20

Baza ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut,do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare",Kodi Civil dhe cfaredo ligji specifik ne Republiken e Shqiperise.

NENI 21

Mosmarrveshjet.

Per mosmarrveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti,si dhe per cfaredo mosmarrveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve,do te jete kompetente Gjykata Shqipare.

26 12 2020

**ORTAKET E SHOQERISE
ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ALPHA POP " SHPK**

AGUSTIN GEGA

RINA BALAJ

